



ZHVILLIMET KRYESORE GJATË 2014 PËR SiCRED ASSISTANCE

Kuadri i Përgjithshëm

Për vitin 2014 SiCRED Assistance sh.p.k., u organizua dhe veproi gjatë gjithë vitit për të bërë publike dhe te dëgjueshme publikisht domosdoshmërinë e marrjes së shërbimit të konsulencës së sigurisë dhe shëndetit në punë, si shërbim të jashtëm në ndërmarrje/institucion dhe nga një subjekt i specializuar e ligjërishit i regjistruar.

Nën këto deviza u përcollën pranë subjekteve me shkrim në mënyrë të përmbledhur përse duhej të blihej ky shërbim konsulence pranë një subjekti të specializuar dhe të jashtëm, sikundër formalisht dhe juridikisht ishte SiCRED Assistance sh.p.k..

Shoqëria SiCRED Assistance sh.p.k.; gjatë vitit 2014 me punonjësit e saj sensibilizoi duke përdorur edhe mediat publike, por edhe duke kontaktuar me shkrim subjektet punëdhënëse për të analizuar anët e forta, dobësitë, mundësitë dhe kufizimet e punëdhënësit në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm këshillimor për shërbimet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Në këtë mënyrë punëdhënësi të cilit i adresohet këshillimi ligjor, do të identifikonte kufizimet dhe mundësitë e tij për t'a prokuruar këtë shërbim jashtë ndërmarrjes dhe institucioni i përzgjedhur të ishte SiCRED Assistance sh.p.k..

Në vëmendje të publikut qartazi u përcoll ideja se përzgjedhje e institucionit të përshtatshëm këshillimor për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë varësisht nga specifikat e entit punëdhënësi, por edhe mundësive ekonomike, zgjedhja më e mirë ishte SiCRED Assistance sh.p.k..

Sicred Assistance sh.p.k.; propagandoi e transmetoi publikisht se personifikon subjektin e përshtatshëm këshillues për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë e përzgjedhja e këtij subjekti nënkuptonte cilësinë e shërbimit të këshillimit dhe kostos më adekuate, duke përfshirë dhe mos anashkaluar, asnjë nga çështjet e imponuara nga ligji për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Sicred Assistance sh.p.k.; nën cilësinë e subjektit këshillimor duke kuptuar që sfidat e aktivitetit në tregjet konkurruese ndryshojnë me shpejtësi me përvojën e fituar me eksperiencë, publikoi zyrtarisht se ofronte zgjidhjet e rekomandimet e përshtatshme, tërësisht të bazuara mbi lirinë e punëdhënësit/ndërmarrjes për të përzgjedhur dhe pranuar këshillimin e ligjshëm. Në fokus të aktivitetit të Sicred Assistance sh.p.k., edhe në dëgjesat publike u adresua se pas këqyrjes në vend të ambienteve të punës e varësisht gjetjeve, sugjerohej rekomandimi i përshtatshëm për të pasur rezultate adekuate me synimin për të optimizuar shfrytëzimin e kapaciteteve të ndërmarrjes për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Ecuria e aktivitetit gjatë 2014.

Gjatë vitit 2014, rezultoi se kemi rinovuar kontratat e para të konsulencës me subjekte private, duke përmirësuar praktikën në vijimësi vazhdimisht në përmirësimin e praktikave për minimizimin e risqeve në vendet e punës, rritjen e eficiencës në punë, uljen e nivelit të stresit, etj. Ndërkohë që si rezultat i propagandës së realizuar gjatë vitit vetëm në fund të vitit u mundësua rritja e numrit të kontratave të këshillimit ligjor, për sigurinë dhe shëndetin në punë, efekti ekonomik i të cilave u reflektua gjatë vitit 2015.